



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.260/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK, në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*” me nr. REF-94062-04-27-2021, me objekt “*Blerje kancelari dhe shtypshkrime*”, me fond limit 1.185.640 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 17.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrenjas.
- Ankimues:** “Marketing & Distribution” ShPK
Autostrada Tiranë-Durrës, km 10, Kashar.
- Autoriteti kontraktor:** Bashkia Prrenjas
Rr. Skënderbej
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.04.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*” me nr. REF-94062-04-27-2021, me objekt “*Blerje kancelari dhe shtypshkrime*”, me fond limit 1.185.640 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëind e dyzet) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 17.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrrenjas.

II.2. Në datën 17.05.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Referuar pretendimeve në ankesë, rezulton se, në datën 26.05.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Marketing & Distribution	985,620.00	I skualifikuar
- Infosoft Office	1027000.00	I skualifikuar
- Adenis Kastrati	1033000.00	I kualifikuar
- Sark	1055220.00	I skualifikuar

- Librari Dyrrahu 1177777.00 I kualifikuar

II.4. Referuar pretendimeve në ankesë, rezulton se, në datën 01.06.2021, operatori ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” ShPK ka paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor duke kërkuar kualifikimin e tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 31.05.2021, operatori ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” ShPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

Arsyeton

III.1. Në datën 28.04.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim” me nr. REF-94062-04-27-2021, me objekt “Blerje kancelari dhe shtypshkrime”, me fond limit 1.185.640 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 17.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrenjas.

III.1.1. Në datën 17.05.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.2. Referuar pretendimeve në ankesë, rezulton se, në datën 26.05.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Marketing & Distribution 985,620.00 I skualifikuar
- Infosoft Office 1,027,000.00 I skualifikuar
- Adenis Kastrati Kastrati 1,033,000.00 I kualifikuar
- Sark 1,055,220.00 I skualifikuar
- Librari Dyrrahu 1,177,777.00 I kualifikuar

III.1.3. Referuar pretendimeve në ankesë, rezulton se, në datën 01.06.2021, operatori ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” ShPK ka paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.4. Sa më sipër rezulton se, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me datë 01.06.2021 dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik me datë 31.05.2021. Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton se, ankimuesi ka referuar si bazë ligjore ligjin 162/2021 “Për prokurimin Publik”. Lidhur me këtë fakt, Komisioni sqaron

ankimuesin se, në faqen e tij zyrtare, ka publikuar njoftimin nr.524 Prot., datë 02.04.2021 drejtuar autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë duke sqaruar ndër të tjera si vijon: *“...Për procedurat e nisura të prokurimit, për të cilat Urdhri i Prokurimit ka dalë para datës 31 Mars 2021, procesi i ankimit administrativ do të ndiqet në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” (i ndryshuar)”*.

III 1.5. Gjithashtu, Agjencia e Prokurimit Publik në njoftimet e publikuara në faqen zyrtare të saj, drejtuar autoriteteve kontraktore si dhe operatorëve ekonomikë, me njoftimin nr. 2109/1 Prot., datë 30.03.2021 ka sqaruar ndër të tjera: *“...për procedurat e prokurimit që do të hidhen në SPE nga Autoritetet Kontraktore, ditën e sotme, datë 30.03.2021, do të zbatohet ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar”*.

Me njoftimin nr.2109/2 Prot., datë 31.03.2021 ka sqaruar si vijon: *“Në zbatim të parashikimeve të nenit 134, pika 1, të Ligjit 162/2020, procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vijnë të realizohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Pra, në zbatim të kësaj dispozite ligjore sqarojmë se, për procedurat e prokurimit për të cilat Urdhri i Prokurimit ka dalë përpara datës 31.03.2021, do të vijohet me zbatim të ligjit nr.9643/2006””*.

Me njoftimin nr.2109/3 Prot., datë 02.04.2021 ka sqaruar si vijon: *“Me qëllim identifikimin e ligjit të zbatueshëm që aplikohet për procedurat që do të shpallen në vijim, APP-ja ju bën me dije të gjithë autoriteteve kontraktore se, në Shtojcën e Njoftimit të Kontratës, pjesë e dokumenteve të tenderit, duhet të cilësojnë ligjin e zbatueshëm për procedurën e prokurimit që do shpallin. Identifikimi i ligjit të zbatueshëm u vjen në ndihmë gjithashtu edhe operatorëve ekonomikë, në përgatitjen për ofertim në procedurën e prokurimit si dhe procesin e ankimit”*.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ si dhe nga sistemi i prokurimit elektronik (SPE), rezulton se, procedura e prokurimit objekt ankimi, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike pas hyrjes në fuqi të ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik”, por Urdhri i Prokurimit me nr.08, është nxjerrë nga autoriteti kontraktor me datë 22.02.2021. Gjithashtu, autoriteti kontraktor, në Formularin e Njoftimit të Kontratës ka parashikuar ndër të tjera se: *“Shenim: Ligji I zbatueshëm do të jetë ligji nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar”*. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë kanë patur dijeni të plotë në lidhje me ligjin e zbatueshëm të procedurës së prokurimit, publikuar kjo nga ana e autoritetit kontraktor.

Referuar njoftimeve të publikuara në faqet zyrtare të KPP dhe APP, si dhe në zbatim të parashikimeve të nenit 134, pika 1, të ligjit nr.162/2020 *“Procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji vijnë të realizohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar*, KPP gjykon se ankesa e operatorit ekonomik ankimues, depozituar me datë 01.06.2021 në autoritet kontraktor si edhe me datë 31.05.2021 në Komisionin e Prokurimit Publik, nuk ka zbatuar ligjin e posaçëm nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili zbatohet për të gjitha procedurat

e prokurimit, për të cilat, Urdhri i Prokurimit ka dalë përpara datës 31.03.2021, dhe do të vijohen në zbatim të ligjit nr.9643/2006, sikundër procedura e prokurimit objekt ankimi.

Komisioni i Prokurimit Publik, ri thekson edhe një herë se në vijim të njoftimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 524 prot, datë 02.04.2021 sqarojmë ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ka parashikuar në nenin 134 dispozita tranzitore procedurale për kohën e fillimit të efekteve të tij: “Procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji vijnë në realizim në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”. Konkretisht, procedura e prokurimit ka nisur *ex lege* para hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. *Inter allia* dhe *mutatis mutandis* në Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë (VUGJL) nr. 3/2013, ku shprehet se: “*Pra është vetë ligjvënësi i cili duhet të shprehet se nuk do të zbatohet ligji i ri procedural por ai i vjetri, gjë që do të thotë se vetë ligji i ri duhet të ketë të përcaktuar qartë se në lidhje me çfarë problemesh dhe deri në çfarë afati kohor do të vazhdojë të zbatohet ligji i vjetër procedural dhe jo ai që është në fuqi. Po kështu, vetë ligji i ri procedural në mënyrë të shprehur duhet të përcaktojë nëse norma e re procedurale nuk do të zbatohet menjëherë, por në një kohë të ardhme, kohë të cilën vetë ligji duhet ta specifikojë. **Nëse kjo ndodh, atëherë, pavarësisht se ligji ka hyrë në fuqi, ai nuk i shtrin efektet menjëherë dhe ndaj çështjeve që janë në gjykim**”, . Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese, *inter allia* në vendimet nr. 106/2002 dhe nr. 11/2009 shprehet se: “*në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe, pra kur vetë ligji ka parashikuar dispozita procedurale tranzitore*”.*

Komisioni i Prokurimit Publik nga leximi me kujdes në mënyrë të integruar dhe harmonizuese të dispozitës tranzitore dhe interpretimit të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese lidhur me zbatimin e dispozitave procedurale tranzitore të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është paralajmëruar parimi i *ultra aktivitetit* që nënkupton se për procedurat e nisura të prokurimit, për të cilat Urdhri i Prokurimit ka dalë para datës 31 Mars 2021, të vijnë në zbatim të parashikimet ligjore material dhe procedurale të bëra nga Ligji 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “*Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*”

“*Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*”

“*Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës*”.

Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

Në nenin 78, pika 5 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Gjatë procedurës së prokurimit, ankesat kundër vendimeve të autoritetit kontraktor duhet të dorëzohen fillimisht pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nesërme punës nga data kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për këtë shkelje të ligjit”.

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor.

III.1.8. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, në rastin konkret nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve dhe shkallëve të ankimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.9. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimes pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim” me nr. REF-94062-04-27-2021, me objekt “Blerje kancelari dhe shtypshkrime”, me fond limit 1.185.640 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 17.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrenjas.
 2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.949 Protokolli, Datë 31.05.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri